



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10/CR001

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 25 mars 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial dhe *ex parte*

Vendim për Caktimin Gjykatëses së Vetme

Gjykatëses së Vetme:

Gjykatëse Marzhori Masëlo

Haxhi Shalës

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), duke vepruar në bazë të nenit 33(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), rregullës 56(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë ("Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve") me anë të këtij vendimi cakton Gjykatësen e Vetme për të vendosur mbi Kërkesën Urgjente për Leje për Vizitë për Arsye Humanitare Bindëse me Tri Shtojca Konfidenciale *Ex Parte* ("Kërkesa").¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 4 shkurt 2025, Trupi Gjykues I lëshoi një urdhër gojor në bazë të rregullës 94 të Rregullores, me të cilin miratoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë të z. Haxhi Shala, ku ai pranoi fajësinë për një akuzë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe një akuzë për frikësim gjatë procedurës penale, dhe e dënoi atë me tre vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.²

2. Më 21 mars 2025, z. Haxhi Shala dorëzoi Kërkesën, që iu njoftua Kryetares më 24 mars 2025.

II. KLASIFIKIMI

3. Kërkesa është klasifikuar si konfidenciale dhe *ex parte*. Rrjedhimisht, vendimi aktual do të mbajë të njëjtin klasifikim në pajtim me rregullën 82(4) të Rregullores, derisa të riklasifikohet më vonë në pajtim me rregullën 3(4) të Rregullores për

¹ CR001/F00001, Kërkesë Urgjente për Leje për Vizitë për Arsye Humanitare Bindëse me Tri Shtojca Konfidenciale *Ex Parte*, 25 mars 2025 (konfidenciale dhe *ex parte*).

² Transkripti, 4 shkurt 2025, f. 616-617 (konfidencial); KSC-BC-2023-10/F00693/RED, version i redaktuar publik i Vendimit të Arsyetuar mbi Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë, 27 shkurt 2025, para. 114.

Caktimin e Gjykatësve.

III. CAKTIMI

4. Kryetarja thekson se Trupi Gjykues u shpërbë pas shpalljes së Aktgjykimit dhe përfundimit të procedurave përkatëse në këtë çështje. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh se aktualisht nuk ka trup gjykues që procedon këtë çështje gjyqësore, Kryetarja cakton Gjykatësen e Vetme në përputhje me nenin 33(2) të Ligjit.

5. Duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, përfshirë edhe kompetencën dhe përvojën përkatëse si dhe disponueshmërinë në këtë moment,

KRYETARJA CAKTON:

Gjykatësen Marzhori Masëlo

si Gjykatëse të Vetme për të vendosur në lidhje me Kërkesën dhe çështje të tjera në lidhje me të.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,

Kryetare e Dhomave të Specializuara

E martë, 25 mars 2025

Në Hagë,

Holandë